

# STATUTI

## “NewWay Consulting “ Sh.P.K”

### STATUTI

#### I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “NewWay Consulting “ Sh.P.K

Sot më datë 10/12/2020, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, në të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "NewWay Consulting "Sh.P.K". - si më poshtë vijon ;

#### KREU I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### NENI 1

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot më datë 10/12/2020, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "NewWay Consulting " Sh.P.K.
- 1.2 Themeluesi i shoqërisë është :
- I. **Z.Evien Dako**, i biri i Maksim-it, i datëlindjes 13/10/1983, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me karte identitetit Nr. Personal I31013068A.
  - II. **Z. Besnik Strati** i biri i Enver-it i datëlindjes 02/07/1967, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me karte identitetit Nr. Personal G70702065L.
  - III. **Znj.Lorena Dako**, e bija e Tajar-it, e datëlindjes 18/05/1988 lindur ne Fier dhe banues ne Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me karte identiteti Nr. Personal I85518075N.

Të cilët kanë vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### NENI 2

#### Objekti

- 2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :
- *Konsulencë në Fushën e Pronësisë Intelektuale, Pronësisë Industriale, dhe në fushën e të drejtave të Autorit.*
  - *Përfaqësimin e titullarëve të të drejtave në fushën e të Drejtave të Autorit dhe në Fushën e Pronësisë Industriale (MARKAT, PATENTAT):*
  - *Mbrojtjen e të drejtave dhe përfaqësimi I interesave të mbajtësve të të drejtave në fushën e pronësisë Intelektuale.*
  - *Konsulence financiare dhe lidhjen e kontratave me përdoruesit.*
  - *Ndërmjetësimin e mbajtësve të të drejtave me përdoruesit e tyre.*
  - *si dhe cdo veprimtari tjetër tregtare sipas legjislacionit në fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas të gjitha licensave që mund të marrin më vonë shoqëria",*
  - *Shërbime Avokatie dhe konsulence Financiare në cdo fushë,*
  - *Studime tregu dhe hartimi i projekteve dhe raporteve financiare,*
  - *Ndërmjetësim në cdo fushe.*

### NENI 3

#### Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

### NENI 4

#### Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Mustafa Matohiti"**, regjistruar në ZRPP Tirane me nr. pasurie 2/53, zona kadastrale 8160, vol. 12, faqe 246 Tiranë

### KREU II

#### NENI 5

##### Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind Mije) Lekë (*\*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë\**). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

*I. Ortaku themelues Z.Evien Dako: Zotërues i 1 (një) me vlerë të përgjithshme 33.333 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë që përben 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

*II. Ortaku themelues Z.Besnik Strati: Zotërues i 1 (një) me vlerë të përgjithshme 33.333 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë që përben 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

*III. Ortaku Themelues Znj.Lorena Dako: : Zotëruese e (një) me vlerë të përgjithshme 33.333 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë që përben 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

### NENI 6

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me arë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar për keto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, vendimet merrën me 2/3 e kuotave pjesëmarrëse
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### NENI 7

#### Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

#### NENI 8

##### Organi Vendimarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 9**

##### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme**

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 10**

##### **Kuorumi**

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 11**

##### **Marrja e vendimeve**

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me dy të tretat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### **NENI 12**

##### **Përfshirja nga e drejta e votës**

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### NENI 13

##### Administrimi

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- 13.2 Afati i emërimit, është 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.4 Administrator e shoqërisë do të jetë **Lorena Dako, e bija e Tajar, e datëlindjes 18/05/1988 lindur ne Fier dhe banuese ne Tiranë identifikuar me karte identiteti Nr. Personal I85518075N.**

Specimenti firmës ..... 

#### NENI 14

##### Kompetencat e Administratoreve

- 14.1 Administratori kanë të drejtë dhe detyrohen të veprojnë si më poshtë:
- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratori thërret Asamblesë e Përgjithëshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

#### NENI 15

##### Përgjegjësia e Administratoreve

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorëve dhe ortakeve /ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.



- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
  - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - jep kredi.

**KREU IV**  
**Viti financiar-ekspertet**  
**NENI 16**

**Viti Financiar**

16. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**NENI 17**

**Ekspertet**

- 17.1 Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per atë per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**  
**NENI 18**

**Prishja dhe likuidimi**

- 18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :
- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - me vendim të gjykatës;
- 18.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri ne likuidim e siper “.
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje
- 18.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**NENI 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**NENI 20**  
**Baza Ligjore**

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- 21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"NewWay "Sh.P.K."**

**EVIEN DAKO**



**LORENA DAKO**



**BESNIK STRATI**

